



Prishtinë, 23 shkurt 2016
Kodi i ZRRE-së: V_792_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-704-2015 të datës 20 shkurt 2015 për shoqërinë "Frogo Food Kosovë" SH.P.K., se ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaike në vendin e quajtur Madanaj-Rrypaj, ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, KK Gjakova Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaike në vendin e quajtur Madanaj-Rrypaj, ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, KK Gjakova, të datës 26.01.2016, të shoqërisë "Frogo Food Kosovë" SH.P.K., me adresë "Kompleksi Royal Hyrja 3, Kati 7 nr. 32 – Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 23 shkurt 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_704_2015 i datës 20 shkurt 2015, i lëshuar shoqërisë "Frogo Food Kosovë" SH.P.K., edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me **20 gusht 2016**.

A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 26.12.2014 nga shoqëria "Frogo Food Kosovë" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaike në vendin e quajtur Madanaj-Rrypaj, ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, KK Gjakova, Republika e Kosovës.



- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, me datë 20 shkurt 2015 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_704_2015, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar se aplikuesit i garantohej lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit Publik në kohëzgjatje 12 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria **“Frogo Food Kosovë” SH.P.K.**, do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- Aplikuesi **“Frogo Food Kosovë” SH.P.K.**, me datë 26.01.2016 ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: që nga koha e lëshimit të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, i kanë ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm për ti plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga ZRRE.
- Aplikuesi ka sqaruar se janë në proces të marrjes së Lejes Ndërtimore nga komuna e Gjakovës, e cila deri më tani nuk është siguruar, ku janë në pritje të marrjes së përgjigjes nga Drejtoria e Urbanizimit të Komunës së Gjakovës dhe kanë pasur takime të rregullta me Drejtorin e lartpërmendur, por meqenëse komuna më parë nuk ka pasur ndonjë përvojë të ngjashme të lëshimit të lejes së ndërtimit për ndonjë park solar, nuk mund të din saktësisht nëse do të mund të marrin lejen e ndërtimit deri në datën e skadimit të Autorizimit Preliminar.
- Gjithashtu ka sqaruar se janë në proces të marrjes së Pëlqimit Mjedisor nga MMPH e cila pritet të përfundoj brenda muajit shkurt 2016. Poashtu ka sqaruar se kanë siguruar edhe pëlqimin Elektroenergjetik nga KEDS SH.A. të cilin e kanë sjelluar në ZRRE s'bashku me kërkesën për shlyerje të afatit të Autorizimit Preliminar. Andaj bazuar në dispozitat ligjore të Rregullës për Procedurën e Autorizimit është kërkuar që të vazhdohet afati edhe për gjashtë (6) muaj i Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të vazhdojmë me kompletimin e dëshmimeve dhe realizimin e projektit në tërësi.



- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Shoqëria **“Frogo Food Kosovë” SH.P.K.**, obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaike në vendin e quajtur Madanaj-Rrypaj, ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, Komuna e Gjakovës, gjegjësisht deri me datën **20 gusht 2016** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-704-2015 i datës 20 shkurt 2015 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.
- IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Gjakovës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së